



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 48, datë 31.05.2022

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT
BASHKIAK NR. 286, DATË 13.08.2002 “STREHIMIN E FAMILJEVE NË
APARTAMENTET E BANIMIT TË MAGAZINAVE TË DUHAN CIGARES NË
ZONËN E RRASHBULLIT DURRËS SIPAS LISTËS SË MIRATUAR ME VKM-NË
NR.34, DATË 20.01.2001, PËRSA I PËRKET LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE TË
STREHUARA NË APARTAMENTET E BANIMIT TË MAGAZINAVE TË DUHAN
CIGARES NË ZONËN E RRASHBULLIT DURRËS, I NDRYSHUAR

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.34, datë 20.01.2001 “Për sistemimin në apartamente banimi të familjeve që banojnë në territorin e Portit të Durrësit“ i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.528, datë 11.09.2018 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.34, datë 20.01.2001 “Për sistemimin në apartamente banimi të familjeve që banojnë në territorin e Portit të Durrësit”, VKB-së nr.286, datë 13.08.2002 “Strehimin e familjeve në apartamentet e banimit të Magazinave të Duhan Cigares në Zonën e Rashbullit Durrës sipas listës me VKM nr.34, datë 20.01.2001”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 898, datë 18.11.2020 “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuara”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Komisioni i Strehimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1, të VKB-së nr.286, datë 13.08.2002 “Strehimin e familjeve në apartamentet e banimit të magazinave të Duhan Cigares në zonën e Rrashbullit Durrës sipas listës së miratuar me VKM-në nr.34, datë 20.01.2001” të ndryshuar, përta i përket listës emërore të familjeve të strehuara në apartamentet e banimit të magazinave të Duhan Cigares në zonën e Rrashbullit, Durrës.
2. Miratimin e listës së familjeve, që banojnë aktualisht në magazinat e Duhan Cigares në zonën e Rrashbullit Durrës, familje të cilat nuk janë përfshirë në listat e miratuara në aktet përkatëse, sipas tabelës bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike ngarkohet të vijojë procedurën në zbatim të legjislacionit në fuqi me Entin Kombëtar të Banesave.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.06.2022

TABELA: LISTA ME EMRAT E QYTETARËVE QË DUHET TË PAISEN ME AUTORIZIME

Nr.rendor	Objekti	Nr.i pasurisë	Sip e apartamentit	Data e Çertifikatës së pronesisë	Emri i qytetarit që banon në apartament
1	Depo-duhani shkozet godina 6	20/114+1-12	89.3	12/6/2013	Ibrahim Leka
2	Depo-duhani shkozet godina 6	20/114+1-3	51.4	12/6/2013	Ilmi Mata
3	Depo-duhani shkozet godina 5	20/113+1-1	55.6	12/6/2013	Anisa Tepelena
4	Depo-duhani shkozet godina 4	20/112+1-24	55.6	12/6/2013	Shefqet Llani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 474 prot.
3

Durrës, më 07.06.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës

KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.48 datë 31.05.2022 “Për miratimin e ndryshimit të pikës 1, të VKB nr. 286, datë 13.08.2002 “Strehimin e familjeve në apartamentet e banimit të magazinave të duhan cigares në zonën e Rrashbullit Durrës sipas listës së miratuar me VKM-në nr.34, datë 20.01.2001, përsa i përket listës emërore të familjeve të strehuara në apartamentet e banimit të magazinave të duhan cigares në zonën e Rrashbullit Durrës”, i ndryshuar”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

